



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1412 / prot.
3

Tiranë më 9.10.2018

REKOMANDIM

Nr. 25, datë 9.10.2018

PËR KONTROLLUESIN FACILIZATION SH.P.K

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "**Facilization**" sh.p.k.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 222 datë 19.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Facilization" sh.p.k., me objekt:

- Verifikimi i realizimit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale dhe ligjshmëria e përpunimit të të dhënave në zbatim të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Facilization sh.p.k. është një kompani që ofron shërbime dhe programe/aplikacione në fushën e Teknologjisë së Informacionit me fokus në sistemin bankar dhe institucionet financiare. Facilization sh.p.k. zhvillon programet/aplikacionet e saj në fushat e menaxhimit të riskut, raportimit rregullator, mbledhjen dhe kthimin e aseteve/kredive me probleme, etj. Kontrolluesi ofron shërbime nga zyrat e saj në Shqipëri, për rajonin e Europës Juglindore dhe vendet e CIS dhe nga zyra e saj në Maltë për klientët e vendeve të Bashkimit European.

Nga hetimi administrativ pranë këtij kontrolluesi, Zyra e Komisionerit konstatoi se:

1.Në kuadër të zbatimit të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, nga verifikimi i formularit të njoftimit të kontrolluesit,

rezultoi se, nuk është përditësuar përmbajtja e njoftimit me ndryshimet që kanë ndodhur në përpunimin e të dhënave përsa i përket të dhënave të deklaruara në rubrikën 4 konkretisht, në lidhje me përpunimin e të dhënave të siguruara nëpërmjet “*Kontrolluesit Elektronik të Aksesit*” në hyrje-daljet e ambienteve të kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet “Formularit të Njoftimit” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Në vijim, Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e shpejtë të kontrolluesit për plotësimin e përditësimit të “Formularit të Njoftimit” duke përmbushur detyrimin ligjor përkatës në postën elektronike info@idp.al të Zyrës së Komisionerit.

2. Nga verifikimi i kryer në faqen online të kontrolluesit www.facilization.com rezulton se kontrolluesi ka publikuar rubrika mbi “Politikat e privatësisë” në gjuhën angleze, por jo në gjuhën shqipe duke mos u dhënë mundësi subjekteve të të dhënave të informohen mbi mundësinë dhe mënyrat e mbledhjes, të të dhënave të tyre personale (qëllimin dhe bazën ligjore përkatëse), afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë dhe ushtrimit të të drejtave të tyre, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar .

Kontrolluesi “Facilization” sh.p.k ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë duke zbatuar legjisllacionin shqiptar dhe për të njëjtën arsye duhet të kryejë informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet politikës së privatësisë në gjuhën shqipe.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

3. Nga verifikimi i kontratave me klientët biznes/banka (në rastin konkret Banka për biznes sh.a., Kosovë), të dhënat personale që përhapen me qëllim nënshkrimin e kontratës apo vendosjen e personave përgjegjës për zbatimin e saj nga Facilization sh.p.k. janë: emri, mbiemri dhe kontakti i postës elektronike e-mail të punonjësve përgjegjës të Facilization sh.p.k. Adresat e-mail të punonjësve janë të krijuara nën domainin e [facilization.com](http://www.facilization.com). Grupi i kontrollit konstatoi se komunikimet me klientët (biznese-banka) kontrolluesi Facilization sh.p.k. i kryhen nëpërmjet shërbimit postar DHL dhe nëpërmjet komunikimeve me postë elektronike e-mail.

Referuar të dhënave të deklaruara nga kontrolluesi në rubrikën 8.1 të “Formularit të Njoftimit” që ka të bëjë me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale për aktivitetin e shoqërisë me klientët biznes jo rezidentë, ky transferim bëhet në formën e: Kontratave të nënshkruara me klientë jashtë Shqipërisë ku të dhënat personale që transferohen janë: *emër, mbiemër, firma e administratorit të kompanisë të kontratës dhe adresa e-mailit.*

Komunikim me e-mail ku e dhëna personale është: *nënshkrimi/signature nën emailin, i cili përmban emrin, mbiemrin e komunikuesit dhe adresën e e-mailit.*

Kontrolluesi është në kushtet e një “Transferimi Ndërkombëtar të të Dhënave”, pavarësisht se qëllimi është për të ushtruar një detyrim kontraktual siç është ndarja e informacioneve/kontakteve të punonjësve për të përmbushur këtë kontratë, ai ka detyrimin e informimit. Nga verifikimi i kontratës së punës të punonjësve të “Facilization” sh.p.k., konstatohet se nuk është i parashikuar qartësisht informimi i subjekteve të të dhënave “punëmarrës” në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave të tyre sipas neni 18 të ligjit.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ, i cili ka qenë i ndërsjellët në funksion të zbatimit të ligjit. Në vijim kontrolluesi është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 8, 18, 21,22, 29, 30, 31 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Facilization sh.p.k në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi Facilization sh.p.k në zbatim të nenit 18 të ligjit, në faqen zyrtare në internet, në rubrikën mbi “Politikat e Privatësisë” të marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave të cilët vizitojnë/kontaktojnë portalin, të jetë në gjuhën shqipe.
3. Kontrolluesi Facilization sh.p.k në zbatim të nenit 18 të ligjit, në kontratën e punës të punonjësve përkatës të marrë masa për informimin e subjektit e të dhënave “punëmarrës” në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave.
4. Përmbushjen nga ana e kontrolluesit Facilization sh.p.k të detyrimeve të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij Rekomandimi, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit

nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 9 / 10 / 2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

